



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
KESHILLI I QARKUT  
DIBER

Nr. 695 prot.

Peshkopi, me 31. 12. 2018

**V E N D I M**

**Nr.28, date 27.12. 2018**

**“Per miratimin e struktures organizative dhe nivelit te pagave te administrates se Keshillit te Qarkut Diber per vitin 2019”**

Mbeshtetur ne Ligjin nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për Veteqeverisjen Vendore”, neni 77, germa “ç”, neni 82, germa “b”, ne Ligjin nr.7961, dt.12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet e mëvonshme, ne Ligjin nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar, ne VKM nr.474, dt.16.06.2011 “Për përcaktimin e standarteve të procedurës që duhet të ndiqet gjatë hartimit dhe miratimit të strukturave organizative të institucioneve të administratës publike”, VKM nr. 142, date 12.03.2014 “Per pershkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve te punes ne institucionet shteterore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, Keshilli i Qarkut Diber ne mbledhjen e dates 27.12. 2018, pasi shqyrtoj Vendimin e Kryesise “Per miratimin e struktures organizative te administrates se Keshillit te Qarkut Diber per vitin 2019”, me 10 (dhjete ) vota pro,

**V E N D O S I :**

1. Te miratoje strukturen e administrates se Keshillit te Qarkut, emertimet e drejtorive, sektoreve dhe pozicioneve te punes, klasifikimin e pozicioneve qe perfshihen ne sherbimin civil si dhe klasifikimin e pozicioneve per efekt page sipas tabelave 1 dhe 2 qe i bashkelidhen ketij Vendimi dhe jane pjese perberese e tij.
2. Vendimi te depozitohet prane institucionit te Prefektit per verifikimin e ligjshmerise.
3. Me zbatimin e ketij Vendimi ngarkohet Drejtoria e MBNJ, Sektori i Finances dhe Sherbimeve.
4. Ky Vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes.
5. Ushpall sot, date 27.12.2018.

**K R Y E T A R I**

**Hajri LAÇI**



Adresa : Bulevardi “Elez Isufi” Peshkopi, Tel & Fax ++355(0) 218 223 24 [www.qarkudiber.gov.al](http://www.qarkudiber.gov.al)